

*Nj. A. Piro*  
*2-teli - shifonera e DMF - 2*  
*dt. 25.01.2023*  
*[Signature]*

Nr.683 S.H.



**BASHKIA MALIQ**  
Zyra e Prokurorit  
Nr. 371 Prokuroria  
Date: 25.1.2023 Në shkrimë  
*D. Luzi*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
FIER

Date 23.01.2023

**NJOFTIM – SHPALLJE**

Per:

- Stenden e Gjykes se Rrethit Gjyqesor Fier;
- Njesia Administrative Pirg, Bashkia Maliq;
- Dosja gjyqesore nr. \_\_pezullimi, date 14.11.2022, te Gjykes se Rrethit Gjyqesor Fier;
- Faqen zyrtare te internetit te Gjykes se Rrethit Gjyqesor Fier;

Ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Fier ne dt.14.11.2022. ka perfunduar se shqyrtuari ceshtja civile, qe i perket:

**PADITES:** Valbona Kararaj

**E PADITUR:** Foti Rakiplari

**OBJEKT:** Leshim autorizimi per te lejuar femijen e mitur per te udhetuar dhe per tu vendosur jashte shtetit me nenen e saj. Lenien e femijes per ritje dhe edukim paditeses.

Njoftimi me shpallje publike kryhet me ane te afishimit te tij:

- Në gjykatën e vendit, ku do të gjykohet mosmarrëveshja;
- në vendin ku personi te cilit I drejtohet njoftimi ka vendbanimin ose vendqendrimi e tij, si dhe ne njesine administrative ka vendbanimin ose vendqendrimin;
- Kur personi te cilit I drejtohet njoftimi është person juridik privat, njoftimi bëhet nëpërmjet afishimit të tij pranë adresës së qendrës së regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ose në regjistrin e organizatave jofitimprurëse;
- njoftimi i aktit bëhet edhe në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykatës, ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për këtë qëllim;

Bazuar ne nenin 133 te K.Pr.Civile nxjerrim kete shpallje per ti komunikuar pales se paditur Foti Rakiplari, me adrese ne Sovjan. Njesia Administrative Pirg, Bashkia Maliq, vendimin date 14.11.2022, te Gjykes se Rrethit Gjyqesor Fier.

**Ju lutemi konfirmoni zyrtarisht afishimin e shpalljes ne kendin e publikimeve te Gjykes Fier, te Njesise Administrative Pirg, Bashkia MALIQ dhe publikimin ne faqen zyrtare te internetit te Gjykes.**

Bashkelidhur edhe vendimin, date 14.11.2022, te Gjykes se Rrethit Gjyqesor Fier.

*Mr. Ilir Rod*

KRYESEKRETARE  
Nike ZYKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
FIER

Nr.Regj.Them. 21012-00138-62-2022(683)

Data ardhjes 18.01.2022

Datë 14.11.2022

**V E N D I M**  
**“PËR PEZULLIMIN E GJYKIMIT”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier e përbërë nga:

**GJYQTARE: SONILA HOXHA**

Me sekretare gjyqësore Eni Gjika, sot me datë 14.11.2022, mori në shqyrtim në seancë përgatitore, çështjen civile me Nr.683 Akti, që i përket:

**PADITËS:**

**Valbona Kararaj**, atësia Kujtim, amësia Dritë, dtl.24.7.1979, lindur në Fier dhe banuese në Rr.”Shëtitorja Republika”, Lagja e Re, Nd.10/8, H.1, Ap.11, Patos, e përfaqësuar nga **av.Marinela Alla**, anëtare e Dhomës së Avokatisë Fier, e pajisur me prokurë të posaçme nr.1018 rep., nr.422 kol., datë 01.09.2020 të noteres Alketa S.Çuko.

**I PADITUR:**

**Foti Rakiplari**, atësia Zenel, amësia Qerime, dtl.03.03.1977, lindur në Sovjan, Korçë dhe banues në Sovjan, Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq, me adresë sipas certifikatës personale në Babenicës, 02460009, Nd.32, H.1, Pirg, Sovjan, 7016, Maliq.

**OBJEKTI:**

1. Dhënien e autorizimit për të lejuar fëmijën e mitur Klea Kararaj për të udhëtuar dhe për tu vendosur jashtë shtetit me nënën e saj.
2. Lënien e fëmijës Klea Kararaj për rritje dhe edukim paditëses.
3. Caktimin e pensionit ushqimor.
4. Rregullimin e mënyrës së takimit të fëmijës me palën e paditur.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 163, 154, 159, 197, 220, 227 të Kodit të Familjes. Neni 349 i KPC. Ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”.

Gjykata si çeli seancën përgatitore të datës 14.11.2022,

## V Ë R E N

1. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është regjistruar çështja civile me palë dhe objekt të cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.
2. Po ashtu, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier më datë 09.09.2021 është regjistruar padia e paditëses Valbona Kararaj, me të paditur Foti Rakiplari me objekt heqjen e përgjegjësisë prindërore të të paditurit Foti Rakiplari për fëmijën Klea Kararaj dhe dhënien e të drejtës së ushtrimit të kësaj përgjegjësie vetëm prindit tjetër, paditëses Valbona Kararaj. Lidhur me këtë padi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka disponuar me vendimin nr.6318(1270), datë 22.12.2021 duke vendosur rrëzimin e saj. Ky vendim nuk rezulton të ketë marrë formë të prerë pasi ndaj tij është paraqitur ankim (sipas shënimit të kryesekretares në vendim).
3. Pasi konstatoi këtë fakt, Gjykata vëren se zgjidhja me vendim të formës së prerë e çështjes civile me nr.1577 Akti, datë 09.09.2021 regjistrimi (përfunduar me vendimin nr.6318(1270) datë 22.12.2021, ndikon në ecurinë e këtij gjykimi. Rezulton se gjykimi civil po zhvillohet për fakte që paraqiten me rëndësi edhe për këtë gjykim civil (konkretisht ushtrimi i përgjegjësisë prindërore në lidhje me fëmijën e mitur).
4. Në kushtet ka filluar një gjykim civil për heqjen e përgjegjësisë prindërore të të paditurit në këtë gjykim, që lidhet me faktet e këtij gjykimi civil (përsa kohë në këtë gjykim padia lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore), gjykata vlerëson se ndodhemi para rastit të parashikuar nga germa (a) e nenit 297 të Kodit të Procedurës Civile, i cili paracakton një nga rastet e pezullimit të gjykimit. Ky nen përcakton se gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur **çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative.**
5. Gjykata thekson se me të rënë shkakun i pezullimit të gjykimit, palët mund të kërkojnë rifillimin e procesit gjyqësor konform nenit 298 të Kodit të Procedurës Civile dhe gjykata do të caktojë, brenda mundësive të saj, një seancë për verifikimin e kushteve të rifillimit të gjykimit.

## P Ë R K Ë T O A R S Y E


Gjykata bazuar në nenin 297(a) të Kodit të Procedurës Civile,

## V E N D O S I

1. Pezullimin e gjykimit të çështjes civile me nr. 21012-00138-62-2022(683) Rregj. Them. datë regjistrimi 18.01.2022 deri në zgjidhjen me vendim të formës së prerë të çështjes civile me palë paditëse : Valbona Kararaj dhe të paditur Foti Rakiplari, përfunduar me vendimin nr.62-2021-6318(1270) date 22.11.2021.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.  
U shpall sot më datë 14.11.2022, në Fier.

**SEKRETARE**

**ENI GJIKA**



**GJYQTARE**

**SONILA HOXHA**